



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2018:026755

Datë: 04.04.2019

Numri i dokumentit: 00267674

P. nr.418/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË, Departamenti i përgjithshëm penal, gjyqtarja **Iirjana Hoti**, me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në lëndën penale kundër të akuzuarit I. K. nga fsh. ... K Gjakovë, për shkak të veprës penale të kanosjes nga neni 185 par.1 të KPRK-ës, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë, PP.nr.763/18 të datës 12.06.2018, gjatë shqyrtimit gjyqësor më datë **26.03.2019**, në prezencën e përfaqësuesit të Prokurorisë - Prokurorit Armend Zenelaj ,mbrojtësit të akuzuarit I. K., av. A. M. , të akuzuarit I. K. si dhe të dëmtuarit A.K., mori dhe të njëjtën ditë publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **I. K.**, nga fshati ..., Komuna e Gjakovës, ku edhe tani banon, nga i ati H. dhe nëna N. e gjinisë O., data e lindjes ... në fshatin ..., Komuna e Gjakovës, ka të kryer shkollën e mesme, pensionist – veteran i luftës, i gjendjes së mesme ekonomike, i martuar baba i 9 fëmijëve, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ID

Bazuar në nenin 363 par. 1 pika 1.1 të KPPK-së:

REFUZOHET AKUZA

Se:

- me dt.24.05.2018, në orë të pavërtetuar ,seriozisht kanos pësonin tjetër me fjalët se do ti shkaktojë ndonjë të keqe me qëllim të frikësimit ose të shkaktimit të ankthit ,në atë mënyrë që përderisa i dëmtuari A.K. nga fsh. ... K Gjakovë , po vendoste një rrethojë prej teli në parcelën me kulturë livadh ,aty afrohet i pandehuri dhe e kanos me fjalët “ nëse nuk largohesh nga këtu ,ti do të hupesh veten dhe djemtë ,sepse kjo tokë është e imja “, me ç ‘rast tek i dëmtuari shkakton ankth dhe frikë .

-me çka do të kishte kryer veprën penale kanosje nga neni 185/1 te KPRK-ës .

Shpenzimet e procedurës penale, bien në barrën e mjeteve buxhetore të Gjykatës.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore DP në Gjakovë, me aktakuzën PP.nr.763/18 të datës 12.06.2018, ka akuzuar të akuzuarin I. K. nga fsh. ... K Gjakovë, për shkak të veprës penale të kanosjes nga neni 185 par.1 të KPRK-ës .

Prokurori i shtetit Enis Gashi gjatë shqyrtimit fillestar të mbajtur me dt.06.12.2018 lexon Aktakuzën e PP.nr.763/2018 të datës 12.06.2018 dhe deklaroi se mbetet në tërësi pranë aktakuzës.

I akuzuari I. K. duke u deklaruar lidhur me fajësinë sipas aktakuzës me të cilën pandehet thekson se nuk e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën ngarkohet meqenëse siç kam deklaruar edhe në stacionin policor të njëjtit nuk i jam kanosur meqenëse e kam kushëri.

I dëmtuari A.K. gjatë shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me dt. 26.03.2019 deklaroi se në këtë fazë të procedurës penale para se gjykata të merr ndonjë aktvendim të ri për thirrjen e serishme të dëshmitarëve të propozuar nga ana e prokurorit deklaroi se me të akuzuarin kemi arritur një marrëveshje jashtëgjyqësore sipas traditave dhe zakoneve të vendit dhe të njëjtit nuk kemi tani e tutje hasmëri mes veti ,ashtu që heq dore nga ndjekja penale dhe i propozoi gjykatës që kjo çështje juridiko penale të mbyllet dhe po ashtu nuk paraqes kërkesë pasurore juridike.

I akuzuari I. K. gjatë shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me dt. 26.03.2019 , deklaroi se para gjykatës premtojë se nuk do të përsëritet një veprim i tillë apo i ngjashëm dhe në të ardhmen do të jem me i kujdesshëm për veprimet e mija

Prokurori i shteti Armend Zenelaj gjatë shqyrtimit gjyqësor me dt.26.03.2019,,deklaroi me qene se në rastin konkret kemi të bëjmë me veprën penale të kanosjes nga neni 185/1 të KPRK-ës e cila vepër ndiqet me propozimin e palës së dëmtuar në rastin konkret i dëmtuari A.K. deklaroi se me të akuzuarin I. K. janë pajtuar pasi që janë bashkëfshatar , andaj prokuroria bazuar në nenin 185 par. 5 të KPRK-ës heq dore nga ndjekja penale ndaj të akuzuarit I. K. sa i përket veprës penale të kanosjes nga neni 185/1 të KPRK.

Pasi që Prokurori është tërhequr nga ndjekja penale ndaj të akuzuarit , Gjykata në bazë të nenit 363 par. 1 pika 1.1 të KPPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë konform nenit 454 par. 1 të KPPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
P nr.418/18 të dt. 26.03.19.

Sekretarja juridike,
Flutur Nagavci

Gj y q t a r j a,
Ilirjana Hoti

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund të paraqitet ankesë ,në afatin prej **15 ditësh** ,nga dita e marrjes se tij në dorëzim ,Gjykatës se Apelit në Prishtinë. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate.

Numri i lëndës: 2018:026755
Datë: 04.04.2019
Numri i dokumentit: 00267674